



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.2024

VENDIM

Nr. 10, datë 18.01.2024

PËR

**PËRBËRJEN E KOMISIONIT TË PËRKOHSHËM PËR SHQYRTIMIN E ANKIMEVE
KUNDËR VENDIMEVE TË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË PËR
ARKIVIMIN E ANKIMIT OSE PUSHIMIN E HETIMIT NDAJ NJË GJYQTARI, PËR
VITIN 2024**

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenin 62, pika 13 të Ligjit nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në vendimin nr. 170, datë 28.05.2020 “Për ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për Shqyrtimin e Ankimeve Kundër Vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për Arkivimin e Ankimit ose Pushimin e Hetimit ndaj një Gjyqtari”, me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, pas procedurës së shortit,

VENDOSI:

1. Përbërja e Komisionit të Përkohshëm për Shqyrtimin e Ankimeve Kundër Vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për Arkivimin e Ankimit ose Pushimin e Hetimit ndaj një Gjyqtari (KPSHA), për vitin kalendarik 2024, është si më poshtë:
 1. Znj. {...}– anëtare;
 2. Znj. {...}– anëtare;
 3. Z. {...}– anëtar.Anëtarë zëvendësues të këtij Komisioni të Përkohshëm janë:
 1. Z. {...}– anëtar;
 2. Znj. {...}– anëtare.
2. Komisioni ushtron veprimtarinë e tij bazuar në Rregulloren “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Përkohshëm për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankimit ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari”, miratuar me vendimin nr. 200, datë 11.06.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
3. Ankimimet objekt i veprimtarisë së KPSHA, të ardhura deri tani dhe për të cilat nuk ka ende një vendimmarrje, dorëzohen pranë Komisionit të Përkohshëm të krijuar në pikën 1 të këtij vendimi, nga anëtari i cili nuk vijon të jetë anëtar i këtij Komisioni. Në çdo rast dokumentohet procesi i dorëzimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR